

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Ndërmarrja për telekomunikime Telekom Serbia shoqëri aksionare, Beograd, me seli të regjistruar në rrugën “Takovska” nr. 2, Beograd, Republika e Serbisë, dorëzuar përmes përfaqësuesit të autorizuar Ognen Trajkovski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 09.03.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin shoqëria Ndërmarrja për telekomunikime Telekom Serbia shoqëri aksionare, Beograd, me seli të regjistruar në rrugën “Takovska” nr. 2, Beograd, Republika e Serbisë, do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi kapitalin themelor të DM-LINK SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR PETROVAC NA MLAVI, me seli të regjistruar në rrugën “Srpskih Vladara” 290, 12300 Petrovac na Mlavi, Republika e Serbisë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të këtij ligji.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksën administrative për njoftimin për përqendrim në shumën prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksat administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria paguese 840..03161, shifra e të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për iniciimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Ligji), më datë 11.02.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Komisioni), u dorëzua njoftim për përqendrim nga shoqëria Ndërmarrja për telekomunikime Telekom Serbia shoqëri aksionare, Beograd, me seli të regjistruar në rrugën “Takovska” nr. 2, Beograd, Republika e Serbisë, me të cilin Ndërmarrja për telekomunikime Telekom Serbia shoqëri aksionare, Beograd do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi kapitalin themelor të DM-LINK SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR PETROVAC NA MLAVI, me seli të regjistruar në rrugën “Srpskih Vladara” 290, 12300 Petrovac na Mlavi, Republika e Serbisë.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të dorëzuara në njoftimin për përqendrim dhe shtojcave të tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Ndërmarrja për telekomunikime Telekom Serbia shoqëri aksionare, Beograd është operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, e regjistruar për telekomunikime kabllore, ndër të tjera ofron shërbime të telefonisë fikse dhe celulare, internet dhe shërbime multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

Ndërmarrja për telekomunikime Telekom Serbia shoqëri aksionare, Beograd ka shoqëri të lidhura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut:

-Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, me seli në rrugën “Maksim Gorki” 11/1-3, Shkup, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtari të telekomunikimeve me tela, e cila ofron këto shërbime: rrjet publik radio-komunikues, qasje me brez të gjerë në internet, shërbime ndër-operatorësh, shërbime telefonike publike të disponueshme në rrjetin publik mobil të komunikimit, ritransmetim të shërbimeve programore televizive, satelit.

Person i lidhur me Shoqërinë për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup¹ është Shoqëria për telekomunikime MTELMOBAJL SHPKNJP Shkup, me seli në rrugën “Maksim Gorki” 11/1-3, Shkup, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Shoqëria për telekomunikime MTELMOBAJL SHPKNJP Shkup operon në tregun e ofrimit të shërbimeve mobile të komunikimeve elektronike (shërbim prepaid) dhe nuk u ofron përdoruesve përfundimtarë shërbim mobil postpaid. Shoqëria për telekomunikime MTELMOBAJL SHPKNJP Shkup është një operator i rrjetit virtual mobil (ORVM) në tregun maqedonas të komunikimeve elektronike dhe ofron shërbime kombëtare, ndërkombëtare dhe roaming për biseda, SMS dhe internet

Gjithashtu, person i lidhur i Ndërmarrjes për telekomunikime Telekom Serbia shoqëri aksionare, Beograd në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është:

Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, me seli në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 17, 1-001/Shkup – Qendër, Shkup, e regjistruar për veprimtari – telekomunikime satelitore.

DM-LINK SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR PETROVAC NA MLAVI është operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, i regjistruar për ofrimin e qasjes në internet dhe shërbimeve të internetit.

DM-LINK SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR PETROVAC NA MLAVI nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe nuk ka realizuar të ardhura në atë territor.

¹ Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, me aktvendimin nr. 08-31/2023, datë 22.03.2023, miratoi përqendrimin me të cilin MTEL SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rrugën Maksim Gorki 11-1/3, 1000 Shkup, do të FITOJ kontrollin mbi SHOQËRINË NEOTEL SHPK Shkup, me seli në Bulevardin Kuzman Josifovski-Pitu nr. 15, 1000 Shkup.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, pasi plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikës 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, megjithëse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke marrë parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ